



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:283078

Datë: 18.09.2020

Numri i dokumentit: 01123433

**P.nr. 1097/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM**, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurve E. K. nga Peja rr. "...", i akuzuar për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope, ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, dhe të pandehurit A. RR. me banim në Peje rr. "...". nr. 37 i akuzuar për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope, ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë –Departamenti i Përgjithshëm PP/II. nr.2678/19, të dt.29.11.2019, pas mbajtjes së sences publike të shqyrtimit fillestar, të dt.07.09.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Muharrem Bajraktari, të pandehurve E. K. dhe A. RR., në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.18.09.2020, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurit:**

**E. K.**, i biri i G. dhe nënës H., e gjinisë D., i lindur me dt. ..., në Pejë, me vendbanim në Pejë, Rr. "...", nr. 83, identifikohet në bazë të pasaportës.nr. personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion-kuzhinier, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, me nr. tel. ... shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

**A. RR.**, i biri i B. dhe nënës L., e gjinisë L., i lindur me dt. ..., në .... ZH-Zvicër, me vendbanim në Pejë, rr. "...". identifikohet në bazë të lnj.nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, i pamartuar, me nr. tel. .... shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

**JANË FAJTORË**

**Sepse,**

**I pandehuri E. K.**

- Me dt. 04.11.2019 rreth orës 22:20 min, afër barrierës së pylltarisë në hyrje të Rugovës K. Pejë, pa autorizim ka poseduar narkotike të llojit marihuane në atë mënyrë që në kohën dhe vendin e lartcekur gjersa i pandehuri E. K. ishte me veturën e tij VV Golf së bashku me të pandehurin A. RR. dhe me pasagjeret tjerë- dëshmitarët D. A. dhe V. K. n e pasi që ishin ndaluar nga policët për një kontroll ku pas kontrollit nga policët tek këmbët e shoferit të pandehurit E. është gjetur substancë e dyshuar narkotike, e cila substancë pasi që ishte konfiskuar ku përmes Nar Test NTX 2000 ka rezultuar se është substancë narkotike e llojit marihuane në sasi prej 0.6 gram,

-Me çka ka kryer veprë penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope , ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

**I pandehuri A. RR.**

- Në kohën dhe vendin e lartcekur gjersa ishte në veturën e lartcekur së bashku me të pandehurin E. K. e pasi që ishin ndaluar nga policët për një kontroll ku pas kontrollimit nga zyrtarët policor tek i njëjti po ashtu është gjetur një sasi e substancës narkotike pasi që ishte konfiskuar ku përmes nar Test NTX 2000 ka rezultuar se është substancë narkotike e llojit marihuane në sasi prej 0.6 gram,

-Me çka ka kryer veprë penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope , ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në aplikim të në nenin 7, 21, 38, 43, 69, 70, dhe nenit 269 par.2 dhe par. 3 të KPRK-së, nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurit i:

**G J Y K O N**

**Te pandehurin E. K.**

- Dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguaj me se largu në afat prej 1 (një) muaji, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

**Te pandehurin A. RR.**

- Dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguaj me se largu ne afat prej 1 (një) muaji, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

-Të pandehurit obligohen që secili veç e veç te paguajnë paushallin gjyqësor ne shumen prej 20 (njëzet) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit obligohen që secili veç e veç te paguajnë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhejtë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ndaj të pandehurve në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së, secilit veç e veç ju **KONFISKOHET**- narkotikun e llojit marihuan me sasi prej 0.6 gram.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II. nr.2678/19, të dt.29.11.2019, kundër të pandehurve E. K. nga Peja rr. "...", i akuzuar për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope, ose analoge nga neni 269 par. 1 te KPRK-së, dhe te pandehurit A. RR. nga ....- Zvicer me banim ne Peje rr."....." nr. 37 i akuzuar për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope, ose analoge nga neni 269 par. 1 te KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 07.09.2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar ku prezent ishin Prokurori i Shteti Muharrem Bajraktari, dhe te pandehurit E. K. dhe A. RR..

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, i ka udhëzuar të pandehurit me të drejtat e tyre, ku në këtë rast të pandehurit deklaruan se i kanë kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës nuk kane nevojë.

Para leximit të aktakuzës Prokurori i shteti e bëri rikualifikimin e veprës penale nga paragrafi 1 i nenit 269 të KPRK-së , në pargarfin 2 të nenit 269 të KPRK-së , për arsy se narkotiku i gjetur te të pandehurit është me pak se 3 gramë përkatësisht 0.6 gramë, ndërsa nga ana tjetër prokurori nuk ka te dhëna se të pandehurit kanë qenë të dënuar, më parë për ndonjë vepër tjetër penale.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, iu ka dhënë mundësia të pandehurve qe të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke i njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri E.K., e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

I pandehuri A.RR., e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet se është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: kallximi penal me nr. .... i datës 18.11.2019, raporti fillestar i incidentit i datës 04.11.2019, raporti i oficerit E.A. #... i datës 04.11.2019 ora 23:55, raporti i oficerit XH. SH. #... i datës 04.11.2019 ora 23:00, dëftesa mbi konfiskimin e pronës, deklarata e te pandehurit E. K. dhënë ne polici me datën 04.11.2019, deklarata e te pandehurit A. RR. dhënë ne polici me datën 04.11.2019, deklarata e dëshmitarit V.K. dhënë ne polici me datën 04.11.2019, deklarata e dëshmitarit V.K. dhënë ne polici me datën 04.11.2019, deklarata e dëshmitarit D.A. dhënë ne polici me datën 04.11.2019, raporti i analizës se narkotikeve i datës 11.11.2019, si dhe fotografi te thikave dhe substancave, si dhe shkresat e lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së , ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurve E.K. dhe A.RR., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope, ose analoge nga neni 269 par.2 te KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurve dhe të njëjtit janë penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë të pandehurit janë të vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e kanë kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për secilin të pandehur veç e veç, gjykata mori, pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryejnë vepra te tjera penale , faktin se me pare nuk kanë qene të dënuar dhe se ndaj tyre nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese ndaj të pandehurve gjykata nuk gjeti nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 dhe 2.7 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenet 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, i obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenet 269 par.3 të KPRK-së gjykata ka konfiskuar narkotikun e llojit marihuan me sasi prej 0.6 gram, të dy të pandehurve secilit veç e veç.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenet 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenet 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,  
P.nr.1097/19 dt. 18.09.2020**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Selvane Bukleta

**GJYQTARI**  
Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.